


RRITEMI NË FRYMËN E LIRISË



DEMOKRACIA DHE TË DREJTAT TONA

AGON (13), BLEONA (13), LEODINA (13), ANITA (14), BLEND A (13), ERINA (13)




Të dashur lexues, mësoni më shumë për demokracinë përmes artikullit tonë

Shteti ynë Kosova, është vend demokratik. Për këtë arsye ne jetojmë në bazë të tolerancës, respektit, barazisë, solidaritetit, etj. Përveç këtyre ne gëzojmë edhe të drejtën që të jetojmë në paqe dhe të lirë. Këto janë dy elemente të tjera të demokracisë. Demokracia është e jona, sepse ne jemi ata që udhëheqim, me anë të votës sonë të lirë. Gjatë procesit zgjedhor ne zgje-

kracia për herë të parë u shfaq në Greqi në vitin 507 para erës sonë. Në atë kohë në Greqi, në votim merrnin pjesë vetëm burrat e pasur, që kishin shumë prona. Kjo ndryshon nga sot, sepse në kohën tonë, të gjithë personat mbi moshën 18 vjeçare kanë të drejtë të votojnë. E kur jemi tek të drejtat, mos të harrojmë të përmendim se demokracia na ofron shumë të drejta. Ne kemi të drejtë të shkollohemi, të shprehemi lirshëm, të kemi identitet, etj.

Ekzistojnë dy lloje kryesore të demokracisë, ato janë: demokracia përfaqësuese dhe ajo e drejtpërdrejtë. Demokracia përfaqësuese, është kur populli me anë të votës i zgjedh përfaqësuesit e tij. Këtë lloj të demokracisë e kemi ne në vendin tonë. Ndërkaq demokracia e drejtpërdrejtë ndodh në shtete më të vogla se Kosova, ku populli i merr vendimet direkt. Demokracia na bën të lumtur. Ne e duam atë dhe me punën dhe me përkushtimin tonë, do ta bëjmë edhe më të mirë.



dhim përfaqësuesit tanë. Kjo nënkupton se vota jonë është shumë vendimmarrëse dhe me shumë rëndësi. Në rast se një person i cili është i racës së verdhë, por jeton në Kosovë, bën shkelje të ligjit, ai person ka të drejtë të gjykohej njëjtë sikurse edhe ne të tjerët. Kjo tregon se barazia është qenësore në demokraci. Pra, demokracia nuk njeh fe, racë, komb, gjini apo gjendje ekonomike. Sikurse çdo gjë tjetër që ka fillet e saj edhe demo-



Autorët e artikullit



Votim i mbyllur



Ne jemi të përgjegjshëm



Bashkëpunimi, toleranca, shprehja e mendimit, janë disa nga elementet e demokracisë



Kuvendi është organi më i lartë ligjvënës, që ndryshe njihet edhe si „Shtëpia e Popullit“



Ne jetojmë në një vend ku të gjithë fëmijët kemi të drejtën e lojës



Ne kemi punuar së bashku në grup duke qenë të respektueshëm ndaj njëri-tjetrit

KONTRIBUTI PËR VENDIN

LEONITA (13), ALBINA (13), DIANA (13), BLEONA (13), PËRPARIMI (14), ALTINI (14)

Ne jemi nxënësit e klasës 8-1 nga shkolla „Nazim Gafurri“ nga Prishtina dhe sot kemi mësuar për qytetarinë aktive. Këto informata do t'i lexoni më poshtë

Nëse je qytetar i Kosovës atëherë je i regjistruar në regjistrin civil, ku në të flitet për të dhëna rreth nesh si: emri, moshë, emri i prindërve, etj. Nëse shoqja ime jeton në Angli dhe ajo vë në Kosovë për vizitë, ajo njëherë nuk është qytetare e Kosovës por duhet të jap disa të dhëna rreth vetes.

Demokracia është formë e qeverisjes nga shumica e njerëzve me të drejta të barabarta.

Të drejtat e çdo qytetari janë: e drejta për të shkuar në shkollë, për të punuar, për të votuar mbi moshën 18 vjeçare dhe e drejta për të formuar dhe për të punuar në organizata jo qeveritare dhe klube e shoqata të ndryshme të cilat ndihmojnë të tjerët.

Që të jesh qytetar aktiv duhet të votosh mbi moshën 18 vjeçare, por nëse dëshiron mundesh edhe të kandidosh për deputet në procesin zgjedhor. Mirëpo, ne si fëmijë nuk kemi të drejtë të votojmë pa i mbushur 18 vjet. Të drejtat e fëmijëve janë të bazuara edhe në Konventën e të Drejtave të Fëmijëve dhe në Kushtetutën e Kosovës, ku ne si fëmijë nuk kemi të drejtë të punojmë, kemi të drejtë të shkojmë në shkollë, të edukohemi si dhe të luajmë.

Qytetarët aktiv kanë disa përgjegjësi: të mësojnë në shkollë, të respektojmë rregulloren e shkollës, të mos ndotim ambientin, të pastrojmë ambientin e ndotur, të ndihmojmë të varfërit duke iu dhënë ushqim apo edhe libra, etj.



Të gjithë duhet ta ruajmë mjedisin



Gazetarët e rinj




Të jesh qytetar aktiv do të thotë të votosh



Ne kemi të drejtën për të shkuar në shkollë

KUSHTETUTA, LIGJ MBI LIGJET

MËRGIM (14), RINOR (14), SARA (13), AGNESA (14), DIARTA (14), RINESA (14)



A dëshironi të njoftoheni më shumë rreth Kuvendit? Atëherë në këtë artikull keni mundësi të lexoni pikërisht për Kuvendin

Të gjithë kemi dëgjuar për Kuvendin. Në Kuvend miratohen ligje që ndikojnë në jetën e të gjithëve. Për këtë duhet të jemi të vetëdijshëm se kë zgjedhim si përfaqësues të popullit.

Votimi në procesin zgjedhor mund të bëhet mbi moshën 18 vjeçare, sepse atëherë jemi më të pjekur dhe dijmë se kush mund të bëjë ndryshime për të mirë e vendin.


Kosova është vend me demokraci përfaqësuese me sistem parlamentar, me të cilin nënkuptojmë që deputetët përfaqësojnë popullin me votat që i jep populli.

Kuvendi në Kosovë përbëhet gjithsej prej 120 deputetëve, ku 100 prej tyre janë të kombit shqiptar, kurse 20 janë të komuniteteve jo shumicë (serb, ashkali, romë, egjiptian, turq dhe boshnjak).

Ligjet mund të propozohen nga deputetët, populli, Qeveria dhe Presidenti. Por, projektligjet shqyrtohen në Kuvend nga deputetët. Nëse një projektligj propozohet p.sh. nga Ministria e Shëndetësisë, ajo shqyrtohet nga Komisioni për Shëndetësi. E njëjta mund të ndodhë edhe në ministritë e tjera, p.sh. Ministria e Arsimit, Ministria e Kulturës, etj.

Funksionet kryesore që i kryen Kuvendi janë: funksioni legjislativ, kontrollues dhe përfaqësues. Funksioni

legjislativ, sepse miraton ose nuk miraton ligjet, ai kontrollues, sepse kontrollon Qeverinë dhe përfaqësues, sepse deputetët që punojnë në Kuvend përfaqësojnë popullin. Të jetosh në demokraci do të thotë të jesh i lirë, që në atë shtet të pavarur dhe demokratik të mos ketë diskriminime por të ketë barazi.



Shprehu lirshëm



Autorët e artikullit



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPËSTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Nazim Gafurri“
Klasa: VIII/1
Vendi: Prishtinë